




REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep.	Nr Prot Br Prot Prot No
DPK	03-02/4323/17
Nr. I faq Broj stranica Nr. pages	Data Datum Date
02	29.12.2017
PRISHTINE	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 26.12.2017, mori:

V E N D I M

I. *Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-3730/17, për zyrtarin e lartë z. Islam Pacolli, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të Interesit dhe mos pajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik .*

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-3730/17, qe për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Islam Pacolli, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Gjatë zhvillimit të procedurës për identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit, është vërejtur se zyrtari i lartë z. Islam Pacolli, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, figuron si person i autorizuar në bizneset private me emër "MABCO KONSTRUKTIONS" sh.p.k dhe N.P.N "MABETEX project engineering" e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm të interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresë zyrtare se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z.Pacolli, ka kontaktuar me zyrtarët e AKK-së, dhe ka shprehë interes për një takim me zyrtaret e AKK-së për tu njoftuar për situatën që është duke u trajtuar.



Lidhur me këtë çështje është organizuar një takim në zyrat e AKK-së, më zyrtarin e lartë z. Islam Pacolli, zyrtarët e AKK-së, e kanë njoftuar zyrtarin e lartë lidhur me rastin e iniciuar.

z. Pacolli, është pajtuar me gjendjen, dhe është zotuar se do të veproj sipas ligjit në fuqi për ta parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit duke sjell dëshmi se nuk do të figuroj si person i autorizuar ne biznes.

Pas këtyre veprimeve të ndërmarra nga z. Islam Pacolli, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës kemi pranuar dokumentin zyrtar të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se zyrtari i lartë z. Islam Pacolli, nuk figuron me si person i autorizuar ne bizneset private me emër "MABCO KONSTRUKTIONS" SH.P.K dhe N.P.N "MABETEX Project engineering".

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga zyrtari lartë z. Islam Pacolli, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, duke bërë ndryshimet në biznes, duke hequr dorë nga përgjegjësit dhe të drejtat e funksionit si personi i autorizuar ne bizneset private janë krijuar rrethana të reja dhe është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë ne ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

